

VENDIM
Nr.409, datë 11.7.2007

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2007, MIRATUAR PËR MINISTRINË E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E PJESSHËM TË SHPENZIMEVE TË KRYERA, PËR TRAJTIMIN SHËNDETËSOR, NË TURQI, TË SË NDJERËS ZNJ. LORENA DRENOFCI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit, të vitit 2007”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2007. në artikullin “Shpenzime operative”, t’i shtohet fondi prej 950 000 (nëntëqind e pesëdhjetë mijë) lekësh, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të kryera, për trajtimin shëndetësor, në Turqi, të së ndjerës znj.Lorena Drenofci.
 2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
 3. Pagesa të bëhet pas paraqitjes së faturave origjinale, të lëshuara prej institucionit të kurimit.
 4. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha